



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në pajtim me nenin 12.1 pika d) të Ligjit Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 39 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 të dt. 11.11.2011 dhe në zbatim të nenit 2 paragrafi 1 të Rregullores për procedurat dhe kriteret e vendosjes së Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve dhe Simboleve, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 15.03.2013, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Këshillit Komunal për Vlerësimin e Meritave Historike e Shoqërore të Personaliteteve dhe Ngjarjeve nga Territori i Komunës së Gjilanit,
Tërësia Etnike Shqiptare dhe më gjerë

- I. Këshilli ka këtë përbërje:
 1. Arzie Nuhiu-PDK,
 2. Naim Musliu-PDK,
 3. Sadudin Berisha-LDK,
 4. Sabit Rrustemi-LDK,
 5. Fadil Gashi-AAK
 6. Blerim Sylejmani-AKR
 7. Tefik Maksuti-G+3
- II. Këshilli në pajtim me rregulloren për procedurat dhe kriteret e vendosjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve do të bëjë vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë, për të cilët në shenjë nderimi mund të propozohet ngritja e përmendoreve, shtatoreve, busteve apo simboleve.
- III. Komisioni pas përcaktimit të propozimit për vlerësim të meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare e më gjerë i'a paraqet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim me një arsyetim të plotë, se në parim janë përmbushur kushtet sipas rregullores në fuqi dhe i propozon Kuvendit të Komunës së Gjilanit të merr vendim përfundimtar lidhur me propozimin.
- IV. Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.